



R KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 1.10.2019

Dokument parlamentar

RAPORT PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E KONTRATËS FINANCIARE, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EVROPIANE TË INVESTIMEVE, PËR PROJEKTIN “SHTRATI I LUMIT LANA – ZHVILLIM URBAN””

- ***Hyrje***

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e kontratës financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për projektin “Shtrati i Lumit Lana – zhvillim urban”, në mbledhjen e tij të datës 1 tetor 2019.

Projekti “Shtrati i Lumit Lana – Zhvillimi urban” do të mundësojë krijimin e një shtrati me regjim hidraulik eficient, për të eliminuar problematikën e përmbytjeve në këtë zonë, si dhe krijimin e hapësirave të nevojshme të zhvillimit urban të zonës. Projekti përfshin punime përgjatë përafërsisht 1.8 km të lumit Lana dhe plotëson rehabilitimin e lumit të kryer përgjatë përafërsisht 16 km në rrjedhën e sipërme të zonës së Projektit në qytetin e Tiranës.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Projektligji “Për ratifikimin e kontratës financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për projektin “Shtrati i Lumit Lana – zhvillim urban” është nismë e Këshillit të Ministrave dhe i paraqitet për shqyrtim Kuvendit mbështetur në nenet 78, 83, pika 1, dhe 121 pika 1 të Kushtetutës.

Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 1 e Rregullores së Kuvendit.

- ***Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit***

Projektligji ka si qëllim ratifikimin e kontratës financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për projektin “Shtrati i lumit Lana – zhvillim urban”, në shumën prej 8 milionë eurosh.

Projekti “Vazhdimi i bulevardit “Gjergj Fishta” dhe “Bajram Curri” dhe rehabilitimi i lumit të Lanës nga Ura Teknologjike deri te kryqëzimi me rrugën “Teodor Keko”” ka për qëllim zgjatimin e bulevardit nga Ura Teknologjike deri në kryqëzimin me rrugën “Teodor Keko” dhe rehabilitimin e shtratis të lumit të Lanës po për këtë segment.

Projekti përfshin zgjerimin e dy bulevardeve, të cilat janë paralele me lumin Lana, përkatësisht Bulevardet "Gjergj Fishta" dhe "Bajram Curri", duke kontribuar në rigjenerimin urban përmes pajisjes së zonës rrethuese të lumit me infrastrukturë urbane dhe përmirësimin e integritit dhe lidhjes së dy brigjeve të lumenjve me Qytetin.

Zona që ndikohet nga projekti shtrihet në një sipërfaqe prej 110 ha. Kryesisht ndërtimet përgjatë lumit të Lanës janë ndërtime informale banimi 1, 2 dhe 3 kate, të vetëndërtuara dhe me kushte minimale të banimit. Këto banesa kanë mangësi të theksuara në lidhje me infrastrukturën sociale dhe ato inxhinierike. Lidhjet me rrjetin e ujit të pijshëm shpesh mungojnë dhe ato furnizohen me ujë pusi, i cili mund të jetë i ndotur.

Për realizimin e këtij projekti duhen:

- krijuar një shtrat me regjim hidraulik eficient për të eliminuar problematikën e përmytjeve në këtë zonë, si dhe duke krijuar hapësirat e nevojshme të zhvillimit urban të zonës deri në kryqëzimin me rrugën Teodor Keko;
- zgjatur bulevardet paralel me lumin me të gjithë infrastrukturën e nevojshme si sinjalistikën, disiplinimin e ujërave të bardha dhe të ndotura, ndriçimin, telekomunikacionin, peizazhin si dhe lidhjen me infrastrukturën ekzistuese;
- ndërtuar 2 ura mbi shtratin e ri të lumit për nevojat e zhvillimit urban;
- kryer punime pastrimi në shtratin e lumit Lana, rregullimin dhe ri-drejtimin e rrjedhës së lumit për të shmangur problemet e përmytjeve në këtë zonë.

Kredia e ofruar nga Banka Evropiane e Investimeve (BEI), ka termat e mëposhtëm:

- Shuma 8 000 000 euro;
- Maturimi 20 vjet, duke përfshirë një periudhë pa pagesë principali prej 4 vjetësh;
- Interes të përcaktueshëm mbi bazën e tregut në momentin e disbursimit.

- ***Vlerësimi i Ligjshmërisë Kushtetuese dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi dhe aktet ndërkombëtare.***

Projektligji është në përputhje me nenet 78, 83, pika 1, dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, si dhe me ligjin nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Në aspektin procedural projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në aspektin formal projektligji përbëhet nga 2 nene.

- ***Vlerësimi i përputhshmërisë së projektligjit me Acquis Communautaire***

Ky projektligj nuk përafron ndonjë legjislacion të BE-së.

- ***Diskutimi në komision***

Gjatë shqyrtimit të projektligjit deputetët shprehën shqetësimet e tyre në lidhje me trajtimin e familjeve të cilëve u shemben shtëpitë në kuadër të realizimit të këtij projekti dhe që nuk janë të pajisura me certifikatë pronësie.

Përfaqësuesit e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe përfaqësuesit e Bashkisë Tiranë, shpjeguan elementët kryesor të kësaj kontrate financiare, si dhe iu përgjigjën deputetëve në lidhje me ecurinë e projektit dhe vazhdimin e tij që do të realizohet me anë të këtij financimi.

Diskutimet në Komision, u përqëndruan kryesisht në ecurinë e deritanishme të këtij projekti, si dhe në mundësinë e gjetjes së një zgjidhjeje të pranueshme për trajtimin e familjeve të cilat humbasin shtëpitë për shkak të këtij projekti.

- ***Përfundim***

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni vlerësoi projektligjin për mundësimin e plotësimit të rehabilitimit të lumit Lana.

Komisioni e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

Besnik BARAJ

Relator

Niko PELESHI

Kryetar